



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

Korçë, më 09. 05. 2022
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

NJOFTIM PËR KANDIDATËT QË KONKURROJNË PËR PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË”, 2022

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, si edhe shkresën e MAS “Për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, njoftojmë kandidatët për hapat dhe procedurat që duhet të ndjekin për t’u regjistruar në portal nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022:

1- Të drejtën për të marrë pjesë në konkurrim për një vend të lirë pune në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar e kanë të gjithë ata kandidatë që kanë përfunduar studimet universitare në fushën e mësuesisë dhe që kanë fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit (licencën). Po ashtu, të drejtën për të konkurruar për një vend pune e kanë edhe ata kandidatë që kanë përfunduar studimet e larta në fushën e edukimit (mësuesisë), para vitit 2011 dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë ose të barazvlefshme me të sipas përcaktimeve ligjore.

2- Kandidatët që kanë të drejtë të konkurrojnë duhet të ngarkojnë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, (<https://mesuespershqiperine.al/>) një kopje të skanuar të dokumenteve origjinale sipas rradhës së përcaktuar më poshtë:

1. Kopje të kartës së indentitetit
2. Vërtetimin e qendrës së banimit
3. Kopje të diplomës / diplomave (bachelor dhe master)
4. Listë e notave të diplomës / diplomave (bachelor dhe master)
5. Kopje të licencës së provimit të shtetit (për të diplomuarit pas vitit 2011)
6. Kopje e librezës së punës (nëse ka qenë ose është punësuar në institucionet arsimore)
7. Kopje të dëshmisë së kualifikimit (nëse zotëron një të tillë)
8. Kopje të certifikatave me kredite të lëshuara nga agjencitë e akredituara nga MAS
9. Kopje të dëshmisë së gjuhës së huaj të mbrojtur në IAL brenda vendit ose certifikata ndërkombëtare të njohura nga MAS në nivelin B2 (nëse ka)
10. Deklarimin nga kandidati për autorizimin e DRAP që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të dërguara. (sipas shtojcës 6 të Udhëzimit)

Çdo kandidat ka të drejtë të konkurrojë deri në tre ZVAP.



Adresa: “Dhimitër Denasi”
Lgj. 18, AL 7001, Korçë
website: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>

3- Gjatë aplikimit në portal, secili kandidat do të duhet të zgjedhë një prej mundësive:

- ✓ Aplikoj për herë të parë
- ✓ Mbart pikët aktuale (dosje + testim)
- ✓ Mbart vetëm pikët e dosjes
- ✓ Mbart vetëm pikët e testimit

4- Të gjithë kandidatët që do të aplikojnë online, duhet të dërgojnë dokumentet e mësipërme edhe përmes postës në adresën e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar - Korçë (*Rruga "Dhimitër Denasi", Lagjia 18 - Korçë*)

5- Kandidatët pjesëmarrës në portalin e vitit të kaluar 2021, duhet të ngarkojnë **detyrimisht online** dosjen e kërkuar si më sipër, por do të dërgojë me postë në adresën e DRAP Korçë formularin e aplikimit të printuar nga sistemi për pjesëmarrje në konkurrim.

6- Kandidatët pjesëmarrës për konkurrim të arsimit parashkollor, do të ngarkojnë **detyrimisht online** dosjen me dokumentet e përcaktuara më sipër, por do të dërgojnë dosjen e tyre të dokumenteve me postë në adresën e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar ku kanë vendbanimin dhe jo në adresën e DRAP Korçë. Vlerësimi i dosjeve të tyre do të bëhet në ato ZVAP ku do të dorëzojnë dokumentet.

7- Në ditën e përcaktuar për testimin e informatizuar që zhvillohet në mjediset e QSHA (Qendrës së Shërbimeve Arsimore), kandidati duhet të ketë me vete formularin e printuar nga sistemi online ku bën aplikimin. Programet për përgatitjen për provimin e informatizuar mund t'i gjeni në faqen elektronike të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) në adresën: <https://www.ascap.edu.al/mesues-per-shqiperine-2021/>

8- Nëse një kandidat nuk dorëzon të gjitha dokumentet e kërkuara si më sipër ai do të skualifikohet nga faza e dytë e konkurrimit (testimi i informatizuar).

9- Nëse një kandidat nuk paraqitet me formularin e pranimit për provimin e informatizuar të dërguar nga DRAP-i në mjediset e QSHA, ai nuk mund të marrë pjesë në këtë testim.

10- Nëse një kandidat konstatohet se ngarkon dokumente të falsifikuara në platformën online, ai humbet të drejtën e konkurrimit dhe kallëzohet për ndjekje penale.

Kujtesë!

☞ - Adresa e email-it me të cilën do të aplikoni duhet të jetë e saktë dhe aktive.

☞ - Të dhënat në sistem duhet të plotësohen me shkronja kapitale duke shënuar me korrektësi shkronjat "ë" dhe "ç".

☞ - Bëni kujdes të mbani mend kodin e aplikimit sipas të cilit do të shpallen rezultatet si edhe fjalëkalimet (password) që do të përdorni për të hyrë në llogarinë tuaj në portal.



GJASHTË HAPA TË THJESHTË PËR APLIKIMIN

